



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 8, datë 07.06.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "NDËRTIMI DHE REHABILITIMI I GODINAVE EKZISTUESE DHE PIKAVE TË REJA TË NDODHURA NË ZONA TË MBROJTURA MJEDISORE"

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të Ministrisë së Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Ndërtimi dhe rehabilitimi i godinave ekzistuese dhe pikave të reja të ndodhura në Zona të Mbrojtura Mjedisore", me propozim të Ministrisë së Mjedisit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit, për secilin nga objektet, i jepen subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit të plotë të pronësisë;
 - b) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.
 - a) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njësive të Qeverisjes Vendore, sipas juridiksionit përkatës territorialo - administrativ;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

